



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 74 dt.28.06.1995

PER
EMERIMIN E NJE SEKRETARI TEKNIK TE KESHILLIT TE
KUJDESTARISE NE STRUKTUREN E APARATIT TE BASHKISE
DHE PER CAKTIMIN E NJE PAGE PER ANETARET E
KESHILLIT TE KUJDESTARISE

Këshilli i Kujdestarisë së Tiranës, në mbledhjen e kësaj date, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë Z.Sali Kelmendi dhe ai i Këshillit të Kujdestarisë pranë Bashkisë së Tiranës Z.Xhemali Hani, lidhur me emërimin e një sekretari teknik të K.Kujdestarisë në strukturën e aparatit të Bashkisë dhe për caktimin e një page për punën e anëtarëve të Këshillit të Kujdestarisë

Vërejti se :

Puna e Këshillit të Kujdestarisë është rritur, ky ka pritur, shqyrtuar e zgjidhur të gjithë kërkesat e ankesat e paraqitura nga qytetarët e Tiranës, për vënien në kujdestari të fëmijëve të mitur, të braktisur ose të personave të tjerë pa përkrahje ose të sëmurë psikikë, kërkesa këto që me ndryshimet e mëdha që ndodhen në vendin tonë me fitoren e demokracisë janë bërë më të mëdha mbasi lidhen direkt me respektimin e të drejtave natyrore të njeriut, ç'ka përbën thelbin e punës së këtij Këshilli. Nisur nga sa më sipër dhe me qëllim që veprimtaria e Këshillit të Kujdestarisë të funksionojë normalisht e të plotësonte kohë dhe me cilësi (brenda ligjeve) vendosjen në kujdestari të personave që janë pa përkrahje, të mitur ose të sëmurë,

mbështetur në pikën.4 dhe të nenit.14 të ligjit Nr.7572,
dt.10.06.1992

VENDOSI

1. Në strukturën e aparatit të Bashkisë së qytetit Tiranës të caktohet vendi i Sekretarit Teknik të Këshillit të Kujdestarisë.
2. Anëtarët e Këshillit të Kujdestarisë, brenda buxhetit të Bashkisë të paguhen për punën që kryejnë në masën që paguhen edhe anëtarët e K.RR.T. të qytetit të Tiranës, çdo antar i këshillit ti caktohet një shpërblim mujor prej 1.000 lekë.
3. Ky vendim hyn në fuqi që nga Janari vitit 1995.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen : Drejtoria Administrimit Financiar të Bashkisë, Sek.Organizim Personelit dhe Zyra e Llogarisë së aparatit të Bashkisë.

KRYETARI

BESNIK PETRELA